



## **Ecje përmes shtigjeve ilire të fshatit Katund i Vjetër/Mirditë**

Milieukontakt Shqipëri në kuadër të projektit “Zhvillimi i qëndrueshëm i turizmit në zonën e Mirditës nëpërmjet promovimit të trashëgimisë kulturore”, mbështetur përmes programit EU4Culture, financuar nga Bashkimi Evropian dhe zbatuar nga Zyra e Kombeve të Bashkuara për Shërbimet e Projekteve në bashkëpunim me Ministrinë e Kulturës, ka realizuar pastrimin dhe markimin e 4 shtigjeve ekzistuese në zonën e Mirditës.


Bashkia Mirditë dhe Info Kulla kanë luajtur një rol shumë të rëndësishëm në këtë projekt duke ofruar ndihmën e tyre për të lehtësuar gjithë procesin e punës në këto shtigje, por jo vetëm.

Zona e Mirditës paraqet një vend ku natyra ka dhuruar peizazhe dhe bukuri të veçanta, si dhe një klimë të mrekullueshme nga zona me lartësi 20 metra deri në 1996 metra mbi nivelin e detit. Mirdita është një vend me trashëgimi kulturore të pasur. Ajo është një prej zonave më të vjetra të Shqipërisë, e njohur për rolin e saj në momentet historike të Shqipërisë dhe mbartëse e një trashëgimie të veçantë kulturore dhe historike.

Natyra është treguar bujare me Mirditën, duke i dhënë një terren të larmishëm në tërësinë e vet. Luginat e lumenjëve, malet e larta, pllajtat në lartësi e brendësi të maleve, ujërat nëntokësore, burimet e lakmueshëm, kanionet, pyjet e shumëllojshëm e gurët e dobishëm janë vetëm një pjesë e bujarisë së natyrës së këtij vendi.

Traditat e vjetra shqiptare përjetohen këtu përmes muzikës, këngëve popullore dhe festave të ndryshme që janë një pjesë e jetës së përditshme të banorëve. Në Mirditë, ndjen një atmosferë të ngrohtë dhe mikpritëse.

Mirdita, treva me emrin e bukur përshendetës, ku në çdo cep të saj gjenden gjurmë të lashtësisë, gjurmë të jetës, gjurmë të një kulture të hershme. Materialet arkeologjike i çojnë gjurmët e jetës në Mirditë në periudhën e Neolitit 6000-3000 vjet para Krishtit. Mirdita është një zonë e bukur me një trashëgimi të pasur kulturore dhe historike. Është një vend që vlen të vizitohet për ata që janë të interesuar për natyrën dhe kulturën e Mirditës.



*Vijat e kuqe në hartë tregojnë shtigjet e markuara për hiking në zonën e Mirditës.*

Për ata që janë të gatshëm për një udhëtim magjik në një vend të veçantë, Mirdita është destinacioni i duhur. Rajoni i Mirditës është pothuajse i panjohur për turistët, pavarësisht iniciativave të zhvillimit në turizëm vitet e fundit. Ka hotele, restorante dhe aktivitete të ndryshme të cilat mund të përfshijnë ecje në mal, njohje me jetën në fshat, vizitë në muze dhe qytete të vogla malore të bukura.

E vendosur në afërsi të Tiranës, aeroportit, porteve kryesore dhe e përshkruar mes për mes nga Rruga e Kombit, Mirdita është një zonë e aksesueshme në një kohë të shkurtër. Mund të praktikohet turizmi ditor deri në disa ditor. Ecja nëpër shtigjet e markuara, i jep mundësinë vizitorit të njihet me natyrën, kullat tipike të zonës, traditën, religjionin dhe gatimet plot shije të zonës. Natyra e saj, e karakterizuar nga male të larta, grykat, livadhet, burimet e shumta, ka krijuar mundësitë e zhvillimit të jetës së egër dhe ka ndikuar në tiparet e jetës së banorëve nëpër fshatra. Monumentet e shumta natyrore gjenden në të gjithë territorin.


Zona e Rubikut gjendet në hyrje të Mirditës. Ajo gjithashtu është e populluar herët dhe mbart një sërë vlerash natyrore dhe kulturore me interes të lartë për tu vizituar. Mali më i lartë në Rubik është Mali i Velës (1172 metër) në majë të së cilit është e vendosur shtatorja e Shën Mërisë. Të shtunën e parë të çdo qershori pelegrinë dhe miq të natyrës ngjiten në majë për të takuar dhe shenjtëruar Zojën Mari.

Rubiku është një qytet i vogël i këndshëm, me hapësira publike të mirëmbajtura dhe shumë i pastër. Qysh në kohët e vjetra vendi ka qenë një qendër ndërlidhëse. Ndërsa disa shkencëtarë mendojnë se emri Rubik rrjedh nga "Rrebiqe", që, pak a shumë, do të thotë shpat i thepisur, të tjerë e shikojnë origjinën nga "Rubigo". I njohur si qytet me tradita të forta të krishtërimit dhe me një pasuri të madhe nëntokësore, Rubiku në fillim të viteve 1900, u shndërrua në një qytet minator. Miniera e bakrit Rubik është ndër qendrat më të vjetra minerare të Shqipërisë.

Aty u prodhuan ar në vitet '60 dhe '70 të shekullit të kaluar. Kategoritë e ecjes në zonën e Rubikut janë me tematikë të ndryshme, si: panoramike, historike, kulturore, religjioze etj.

Fshati Katund i Vjetër është qendër e ekoturizmit në zonën e Mirditës, ku akomodimi, i shoqëruar me gatimet plot shije, është një motiv që të shtyn ta vizitosh sërish me kënaqësi.

Ecja në Rubik dhe përreth tij ofron anë historike, religjioze, kulturore dhe një peizazh panoramik të mrekullueshëm. Larg nga nxitimi dhe smogu i qyteteve të mëdha, kjo luginë e pyllëzuar ofron një atmosferë pa stres e pa alergji. Shëtitjet interesante janë garantues të një rikuperimi të qëndrueshëm. Stresi dhe lodhja largohen si me magji nga pamjet piktoreske dhe natyra.



### *Qyteti i Rubikut i fotografuar nga Alfred Nikolli*

Infokulla Mirdita përfaqëson Turizmin e Bashkisë Mirditë dhe koordinon informacionin turistik në Mirditë dhe jo vetëm. Qëllimi i Infokullës është zhvillimi e ekoturizmit në rajon dhe përmirësimi i treguesëve ekonomiko-social të popullsisë nëpërmjet tërheqjes së vëmendjes së vizitorëve me veçoritë e natyrës, kulturës dhe historisë së rajonit duke nxitur kuriozitetin dhe interesimin për njohjen e vendit dhe të njerëzve të tij përmes kontaktit të drejtpërdrejtë. Instalacione të ndryshme, fotografi dhe ekspozita etno-historike paraqesin një tablo gjithëpërfshirëse të një rëndësie të veçantë për rajonin. Infokulla është një nismë private dhe një dhuratë e "Partneritetit Shqiptaro-Austriak - Marianne Graf (AAP)" për Bashkinë Mirditë. Bashkia Mirditë menaxhon turizmin (Infokullën) me përgjegjësi dhe autoritet të plotë dhe në bashkëpunim e mbështetjen e Marianne Graf realizon aktivitete të ndryshme, si dhe nisma në ekoturizëm. Si godinë gjendet ne qytetin historik te Rubikut.



Fshati turistik “Katund i Vjetër” shtrihet në të dy anët e përroit Rubik, që zbret nga Mali i Velës, mbi të cilin ka pasur rreth 20 mullinj bloje. Fshati paraqet interes nga natyra e virgjër dhe gatimet plot shije që ofrojnë subjektet që shërbejnë në fushën e turizmit. Klima në këtë zonë është mesdhetare dhe lugina e Katundit të Vjetër ndodhet 70-600 metër mbi nivelin e detit. Kontrastet e lartësisë japin shumëllojshmërinë e relievit,

florës dhe faunës. Bimësia është e larmishme, duke filluar nga shkurret mesdhetare, deri te drurët e lartë.

Prania e gështenjave në fshatin Katundi i Vjetër e bën këtë zonë edhe më atraktive për t'u vizituar në periudhën e vjeshtës.

Gjithashtu, bimët mjekësore janë shumë të pranishme.

Gjatë ecjes në fshat bien në sy kullat e vjetra dhe fermat e vogla fshatare. Aktivitetet ekoturistike, që përfaqësohen nga operatorët e ndryshëm si Eko-Hotel Marub, Bujtina Dini, Baven Toven Naturae frekuentohen jo vetëm nga shqiptarët, por edhe nga vizitorë të shumtë me kombësi të ndryshme. Katër shtigje për hiking i japin mundësi vizitorëve të shijojnë peisazhet dhe objektet historike.

### **Monumentet Kulturore në Rubik kemi:**

Kalaja Antike e Rubikut

kategori I

Piktogramet në Strehën Shkëmbore pranë Rubikut

kategori I

Kisha dhe Manastiri i Kishës në Rubikut

kategori I

Banesa e Abat Prend Doçit

kategori II

## **Katund i Vjetër – Kisha e Shën Gjergjit- Erzë**



**Sh\_Mr\_002 (Katund i Vjetër – Kisha e Shën Gjergjit- Erzë)**

Distance	4700 m	Starting point	140 m
Duration	2:30	Highest point	720 m
Difficulty	Moderate	Finish point	720 m
		Elevation gain	580 m

Është një itinerar interesant, ecja deri mbi mesataren ku mund të gërshetohen interesa sportive, natyrore dhe kulturore. Fillimi i shtegut dhe pika e parë e interesit mund të jetë Bujtina Dini.



Pastaj shtegu fillon ngjitjen e butë nëpërmjet një pylli të dendur kryesisht me shkurre. Ecje e këndshme e cila është gjithmonë nën hijen e pemëve, dhe me pjerrësi të vogël të pranueshme nga të gjithë. Arrihet deri të varrezat, ku mund të veçojmë kishën e Shën Gjergjit, një nga më të vjetrat në Mirditë me një histori të gjatë dhe mjaft e njohur në zonë. Kisha ndodhet në Qafë-Fiku të Katundit të Vjetër. Në dokumenta përmendet si San Giorgio del Fico.



Për herë të parë përmendet në një letër që Venediku i dërgon Papës, shtyrë nga Gjon Kastrioti, në vitin 1407. Bëhet fjalë për uzurpimin që Ipeshkvi i Lezhës donte ti bënte 12 kishave që ishin pjesë e Peshkopatës së Arbërisë (Episcopatus Arbanensis). Kisha e Shën Gjergjit përmendet në relacionet e B. Orsinit në vitin 1629, Frang Bardhit në vitin 1636, B.Orsinit në vitin 1638, Gj.Vlidanjit në vitin 1672, etj. Kisha e Shën Gjergjit në Katundin e Vjetër, ruhet me gjurmë të restaurimeve të shumta që ka pësuar në kohë të ndryshme.

*Foto: Infokulla Mirditë*

Kisha e Shën Gjergjit ka qenë për shumë kohë kishë famullitare e Kryezezit. Përmendet që në vitin 1407, në një letër të Papës Gregori XII drejtuar Arqipeshkëvit të Tivarit. Përmendet në mënyrë konstante nga relatorët e shek. XVII, XVIII, XIX, etj. Sipas relacionit të Ipeshkëvit të Lezhës Benedikt Orsini, në vitin 1629 kisha e Shën Gjergjit ishte e dëmtuar. Në vitin 1748, Kryezezi riorganizohet përsëri si famulli në vete, me kishë famullitare Shën Gjergjin, pasi për disa kohë kishte qenë pjesë e famullisë së Velës.

Në kishën e Shën Gjergjit, në fund shek. XIX dhe fillim të shek. XX, ka shërbyer prifti misionar austriak Fabian Barcata. Në këto vite të shërbimit të tij në Kryezez, shkroi romanin “Lule”, që përshkruan jetën e banorëve të zonës së Rubikut. Barcata la gjithashtu dorëshkrimin me titull “Ditari im shqiptar”. Për fat të mirë i ruhen një pjesë e mureve dhe disa elemente arkitektonike të veçantë që të çojnë drejt mesjetës.

Pasi lihet pas Kisha vazhdon ngjitja drejt Veri Perendimit ku gjendesh i rrethuar nga pamje shumë të bukura. Bimësia e shumtë me pemë të larta, shkurre dhe bimë medicinale të shoqëron në ngjitjen drejt malit. Banorët e zonës tradicionalisht krahas blegtorisë dhe bujqësisë kanë mbledhur dhe



përdorur bimët tradicionale për nevoja ekonomike.

Ngjitja vazhdon drejt një pllaje rrëzë faqes shkëmbore të malit ku shikohen një sërë tarracimesh

dhe rrënoja ndërtimesh prej guri. Këtu mund të përmendet vetëm stan që është i ruajtur relativisht mirë nga ana ndërtimore. Mund të shikohen si janë ndërtuar muret, dritaret me frëngji, tymtari për ngrohje dhe gatim, vatha e bagëtive si dhe elemente të tjerë arkitektonik. Përveç njohjes me traditat baritore të zonës, vendi përreth të ofron mundësi të shkëlqyera për shlodhje dhe piknik.

Më tej vazhdohet ngjitja nëpër një shteg të ngushtë nëpër faqen shkëmbore me gurë gëlqerorë dhe bimësi të dendur. Pasi ngjitesh lart, sipër faqes shkëmbore pamja që të ofrohet është e mrekullueshme në 360 gradë, ku mbizotëron sigurisht mali i Velës. Lugina e Fanit të shfaqet gjithashtu nën kodrat e shumta, duke të dhënë një panoramë të aktivitetit të ashpër vullkanik gjatë krijimit. Format e shumta karstike shfaqen hap pas hapi gjatë ecjes. Pas disa minutave ecjeje shfaqen Fushat e Erzës. Të rrethuara nga mali ato ngjajnë si një arenë ku janë ndeshur perënditë. Erza, gjendet në shpatet e Malit të Velës në Veri Perëndim të fshatit Katund i Vjetër dhe ofron një vend interesant për vizitorët. Në kreshtën e saj mund të shijosh pamjen e bukur që shkon deri në detin Adriatik. Në pranverë aroma e luleve ndjehet kudo. Për këtë arsye ky vend ka marrë emrin Erzë.

Në Qafën e Erzës gjenden burime uji si dhe pema shekullore e Bershemit, e cila ka vlera shkencore (biologjike), didaktike dhe turistike. Bershemi ka shërbyer që herët si pikë referimi për udhëtarët e këtyre anëve. Lartësia e drurit është rreth 12 metër -15 metër, diametër mbi 1 m. Moshë është mbi 100 vjeçare.



Bershemi është pika kulminante e këtij shtegu. Zbritja përveç nga erdhem kemi dhe dy drejtime. Njëri shteg përshkohet duke zbritur drejt fshatit Rrëja e Zezë ku zbritja kalon nëpër shpatin shkëmbor të veshur me bimësi të dendur, derisa zbritet tek stanet e fshatit. Aty mund të soditësh Gurin e Qytetës, një tjetër monument që tregon për hershmërinë e banimit në këto zona. Më pas ndiqet rrjedha e burimeve të Përroit të Bardhë deri sa zbritet në rrugën kryesore të fshatit. Ndërsa shtegu tjetër vjen nga Bershemi në fshatin Qafë Munaz. Përveç bimësisë në këtë fshat gjendet dhe Gurra e cila shërben si ujësjellësi i qytetit Rubik. Aty gjendet gjithashtu një ujvarë e cila shërben si pikë pushimi përgjatë shtegut që të nxjerr tek Info-Kulla Mirditë.



*Foto: MIRDITA  
Histori dhe aktualitet*

Shtegu është i përshtatshëm në çdo stinë, por stina e pranverës është më e këshillueshme për shkak të numrit të madh të luleve të egra të cilat shkëlqejnë në Erzë duke e bërë udhëtimin më piktoresk.

*Ky material u prodhua nga Milieukontakt Shqipëri, me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian. Përmbajtja e tij janë përgjegjësi e vetme e Milieukontakt Shqipëri dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e Bashkimit Evropian dhe/ose UNOPS-it.*




## Hiking through the Illyrian paths of the village Katund i Vjetër/Mirditë

Milieukontakt Albania within the project “Sustainable Tourism Development of Mirdita through Promotion of Culture Heritage”, supported through EU4Culture program, financed by the European Union and implemented by UNOPS in cooperation with the Ministry of Culture, has carried out the cleaning and marking of 4 existing paths in the area of Mirdita.

Mirdita Municipality and Info Kulla have played a very important role in this project by offering their help to facilitate the entire work process on these paths, but not only.

Mirdita region represents a place where nature has given unique landscapes and beautiful places, as well as a wonderful climate ranging from 20 meters to 1996 meters above sea level. Mirdita is a place with a rich cultural heritage. It is one of the oldest areas in Albania, known for its role in the historical moments of Albania and as a bearer of a distinct cultural and historical heritage.

Nature has been generous to Mirdita, providing it with a diverse terrain. The river valleys, towering mountains, high-altitude plateaus within the mountains, underground waters, enviable water sources, canyons, diverse forests, and valuable stones are just a part of the richness of nature in this region.



Old Albanian traditions are experienced here through music, folk songs, and various festivals that are a part of the daily lives of the residents. In Mirdita, one can feel a warm and welcoming atmosphere.

Mirdita, a region with a beautiful greeting name, where in every corner, traces of antiquity, traces of life, and traces of an early culture are found. Archaeological materials trace the life in Mirdita back to the Neolithic period 6000–3000 years BC. Mirdita is a


beautiful area with a rich cultural and historical heritage. It is a place worth visiting for those interested in the nature and culture of Mirdita.

*The red lines on the map indicate the marked hiking paths in the Mirdita area.*

For those who are ready to start a magical journey to a special place, Mirdita is the right destination. The Mirdita region is almost unknown to tourists, despite the initiatives for development in tourism in recent years. There are hotels, restaurants, and various activities that can include mountain hiking, getting to know village life, visiting museums, and exploring beautiful small mountain towns.

Located near Tirana, the airport, major ports, and traversed by the National Road, Mirdita is an easily accessible area in a short period of time. Tourism can be practiced for a day up to several days. Hiking along marked trails provides visitors with the opportunity to acquaint themselves with the nature, typical towers (Kulla) of the region, tradition, religion, and the delicious local cuisine. Its nature, characterized by high mountains, cliffs, meadows, and numerous water sources, has created opportunities for the development of wildlife and influenced the characteristics of village life. Numerous natural monuments are found throughout the territory.

The Rubik area is located at the entrance of Mirdita. It has also been inhabited early on and carries a series of natural and cultural values with high interest in being visited. The highest mountain in Rubik is Vela Mount (1172 m), on the summit of which the statue of Saint Mary is located. On the first Saturday of every June, pilgrims and nature enthusiasts climb to the summit to meet with the Mother of Jesus. Rubik is a small, pleasant town with well-maintained public spaces that are also very clean. Since ancient times, the area has been a hub of connection. While some scholars believe that the name Rubik derives from "Rrebiqe," which roughly means a sharpened blade, others see its origin in "Rubigo." Known as a town with strong Christian traditions and rich underground resources, Rubik, in the early 1900s, was transformed into a mining town. The Rubik copper mine is among the oldest mining centers in Albania.



Gold was produced in the 1960s and 1970s. The hiking categories in the Rubik area cover various themes, such as panoramic, historical, cultural, religious, etc. The village of Katund i Vjetër is an ecotourism center in the Mirdita area, where accommodation, accompanied by delicious meals, is a motivating factor to revisit with pleasure. Hiking in and around Rubik offers historical, religious, cultural aspects and a marvelous panoramic landscape. Far from the rush and smog of large cities, this forested valley

provides a stress-free and allergy-free atmosphere. Interesting walks are a guarantee for sustainable recovery. Stress and tiredness disappear as if by magic.

*Rubik city captured by Alfred Nikolli*



InfoKulla Mirdita represents Tourism branch in the Municipality of Mirdita and coordinates tourist information in Mirdita and beyond. The purpose of the Information Point (InfoKulla) is the development of ecotourism in the region and the improvement of the socio-economic indicators of the population by attracting the attention of visitors to the unique features of the area's nature, culture, and history, encouraging curiosity and interest in getting to know the place and its people through direct contact. Various installations, photographs, and ethno-historical exhibitions present a comprehensive tableau of particular importance for the region. The Information Center (InfoKulla) is a private initiative and

a gift from the "Albanian-Austrian Partnership—Marianne Graf (AAP)" to the Municipality of Mirdita. The Municipality of Mirdita manages tourism (InfoKulla) with full responsibility and authority and, in collaboration with the support of Marianne Graf, carries out various activities and initiatives in ecotourism. The center is located in the historical town of Rubik.

The touristic village of Katund i Vjetër stretches on both sides of the Rubik River, descending from Vela Mount, where there used to be around 20 mills. The village is of interest due to its untouched nature and the delicious dishes offered by tourism-related establishments. The climate in this area is Mediterranean, and the Katund i Vjetër valley is located between 70-600 meters above sea level. The contrasts in altitude contribute to the diversity of the terrain, flora, and fauna. The vegetation is varied, ranging from Mediterranean scurbs to tall trees. The presence of chestnut trees in the village of Katund i Vjetër makes this area even more attractive to visit in the autumn.

Additionally, medicinal plants are abundant. During walks in the village, one can admire the old towers and small village farms. Ecotourism activities, represented



by various operators such as Eko-Hotel Marub, Bujtina Dini, and Baven Toven Naturae, are frequented not only by Albanians but also by visitors of various nationalities. Four hiking paths provide visitors with the opportunity to enjoy the landscape and historical sites.

**Cultural Monuments in Rubik include:**

- |   |             |
|---|-------------|
| Ancient Castle of Rubik                 | Category I  |
| Pictograms on the Cliff Roof near Rubik | Category I  |
| Church and Monastery in Rubik           | Category I  |
| Residence of Abbot Prend Doçi           | Category II |

**Katund i Vjetër – Church of Saint George- Erzë**



**Sh\_Mr\_002 (Katund i Vjetër – Kisha e Shën Gjergjit- Erzë)**



Distance	4700 m	Starting point	140 m
Duration	2:30	Highest point	720 m
Difficulty	Moderate	Finish point	720 m
		Elevation gain	580 m

It is indeed an interesting itinerary, combining sports, nature, and cultural interests. Starting the trail at Bujtina Dini adds a cultural touch to the journey.

The journey continues with a gentle ascent through a dense forest, primarily covered with shrubs. This pleasant hike is always under the shade of trees and features manageable inclines for all. You'll reach the cemetery, where you can highlight the Church of St. George, one of the oldest in Mirdita with a long and well-known history in the area. The church is located in Qafë-Fik of the Old Village. In documents, it is mentioned as San Giorgio del Fico.



For the first time, it is mentioned in a letter sent by Venice to the Pope prompted by Gjon



Kastrioti, in the year 1407. The context revolves around the usurpation that the Bishop of Lezha intended to carry out against the 12 churches that were part of the Bishopric of Arbëria (Episcopatus Arbanensis). The Church of St. George is mentioned in the relations of B. Orsini in 1629, Frang Bardhi in 1636, B. Orsini in 1638, Gj. Vladanjit in 1672, and so on. The Church of St. George in the Old Village has been preserved with traces of various restorations it has undergone over different period.

*Pic by: Infokulla Mirditë*

The Church of St. George has been the parish church of Kryezezi for a long time. It is mentioned as early as 1407 in a letter from Pope Gregory XII addressed to the Archbishop of Tivari. It is consistently mentioned by chroniclers of the 17th, 18th, and 19th

centuries. According to a letter of the Bishop of Lezha, Benedikt Orsini, in 1629, the Church of St. George was damaged. In 1748, Kryezezi was reorganized as an independent parish, with the parish church of St. George, after being part of Vela's parish for some time.

In the late 19th and early 20th centuries, the Austrian missionary priest Fabian Barcata served in the Church of St. George. During his service in Kryezezi, he wrote the novel "Lule," describing the lives of the residents of the Rubik area. Barcata also left a manuscript titled "My Albanian Diary." Fortunately, some parts of the walls and distinctive architectural elements are preserved, leading towards the medieval period.

After the church, the ascent continues towards the northwest, where you find yourself surrounded by beautiful views. The rich vegetation with tall trees, bushes, and medicinal plants accompanies the journey towards the mountain. The local residents, besides engaging in livestock and agriculture, traditionally gather and use traditional plants for economic needs.

The ascent continues towards a slope on the rock face of the mountain, where a series of terraces and ruins of stone structures are visible. Here, only a relatively well-preserved dwelling is worth mentioning in terms of construction. The walls, windows with shutters, chimneys for heating and cooking, livestock sheds, and other architectural elements can be seen. In addition to gaining insight into the local pastoral traditions, the surroundings offer excellent opportunities for relaxation and picnicking.

The ascent continues along a narrow path on the rocky side with limestone rocks and dense vegetation. After climbing higher, the view that unfolds above the rock face is magnificent in 360 degrees, dominated by the mountain of Vela. The Fan Valley also appears beneath numerous hills, providing a panorama of the intense volcanic activity during creation. Various karstic formations become visible step by



step during the hike. After a few minutes of walking, the Erza Fields come into view. Surrounded by mountains, they resemble an arena where gods might have clashed. Erza is located on the slopes of Mount Vela in the northwest of the village of Katund i Vjetër, offering an interesting place for visitors. From its crest, you can enjoy a beautiful view that extends to the Adriatic Sea. In spring, the scent of flowers is everywhere. For this reason, this place is named Erza.



At the Erza Pass, there are water sources and the centuries-old Bershemi tree, which holds scientific (biological), educational, and touristic value. Bershemi has long served as a reference point for travelers in these areas. The height of the tree is around 12–15 m, with a diameter of over 1m. Its age is over 100 years.

Bershemi is the highest point on this trail. The descent,

aside from the route we came from, has two directions. You can descend towards the village of Rrëja e Zezë. The descent from the village of Rrëja e Zezë passes through the rocky slope covered with dense vegetation until it reaches the village's stone structures. There, you can explore the City Stone, another monument that attests to the ancient history of habitation in these areas. Then, you follow the flow of the White Stream until it descends to the main road of the village.



As for the other trail, it comes from Bershemi to the village of Qafe Munaz. In addition to the rich vegetation in this village, there is also the Gurra, which serves as the water supply for the city of Rubik. There is also a spring that serves as a resting point along the trail that leads you to the Mirdita Information Point (InfoKulla).

*PIC: MIRDITA  
Histori dhe aktualitet*

The trail is suitable for hiking in any season, but spring is particularly recommended due to the abundance of wildflowers that bloom in Erza.